

32003R0622

Rregullorja e Komisionit (KE) nr. 622/2003 e 4 prillit 2003 që përcakton masat për zbatimin e standardeve bazë të përbashkëta në fushën e sigurisë së aviacionit (tekst kuptimi i të cilit lidhet me ZEE)

Gazeta Zyrtare L 089, 05/04/2003 fq. 0009 - 0010

Rregullorja e Komisionit (KE) nr. 622/2003 e 4 prillit 2003 që përcakton masat për zbatimin e standardeve të përbashkëta bazë në fushën e sigurisë së aviacionit (tekst kuptimi i të cilit lidhet me ZEE)

Komisioni i Komuniteteve Europiane

Duke pasur parasysh Traktatin Themelues të Komunitetit European,

Duke pasur parasysh Rregulloren (KE) nr. 2320/2002 e Parlamentit European dhe e Këshillit të 16 dhjetorit 2002 që përcakton rregullat e përbashkëta në fushën e sigurisë së aviacionit civil [1] dhe në veçanti nenit 4 pika 2 të tij,

Duke pasur parasysh se:

- (1) Komisioni duhet të miratojë masat për zbatimin e standardeve bazë të përbashkëta, mbi sigurinë e aviacionit në të gjithë Bashkimin European. Rregullorja është instrumenti më i përshtatshëm për këtë qëllim.
- (2) Në përputhje me Rregulloren (KE) nr. 2320/2002 dhe për të parandaluar veprimet paligjshme, masat e përcaktuara në shtojcën e kësaj rregulloreje duhet të mbahen sekret dhe të mos botohen.
- (3) Për këtë qëllim, është i nevojshëm të lejohet dallimi ndërmjet aeroporteve në bazë të vlerësimit të rrezkut në çdo aeroport. Si rrjedhim, Komisioni duhet të njoftohet për aeroportet që konsiderohen se paraqesin një rrezik më të vogël.
- (4) Masat që do të zbatohen duhet të lejohen të ndryshojnë në varësi të tipit të aktivitetit të aviacionit. Komisioni duhet të njoftohet kur të zbatohen masat kompensuese për të siguruar nivele të barabarta sigurie.
- (5) Masat e parashikuara në këtë rregullore, janë në përputhje me mendimin e Komitetit për Sigurinë e Aviacionit Civil,

KA MIRATUAR KËTË RREGULLORE:

Neni 1 Qëllimi

Kjo rregullore përcakton masat e nevojshme për zbatimin dhe përshtatjen teknike të standardeve bazë të përbashkëta lidhur me sigurinë e aviacionit që do të ndërthuren në programin kombëtar të sigurisë së aviacionit civil.

**Neni 2
Përkufizimet**

Për qëllimet e kësaj rregulloreje zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

“Programi kombëtar i sigurisë së aviacionit civil” nënkupton ato rregullore, praktika dhe procedura të miratuara nga Shtetet Anëtare sipas nenit 5 të Rregullores (KE) nr. 2320/2002 për të garantuar sigurinë e aviacionit civil në territorin e tyre,

“Autoritet i Përshtatshëm” nënkupton autoritetin kombëtar të caktuar nga një Shtet Anëtar në mbështetje të nenit 5 pika (2) të Rregullores (KE) nr. 2320/2002 përgjegjës për koordinimin dhe monitorimin e zbatimit të programit kombëtar të sigurisë së aviacionit civil.

Neni 3 **Konfidencialiteti**

Masat e referuara në nenin 1 janë përcaktuar në shtojcë.

Këto masa mbahen sekret dhe nuk do të botohen. Ato bëhen të ditura vetëm për personat e autorizuar nga një Shtet Anëtar ose nga Komisioni.

Neni 4 **Njoftimi**

Shtetet Anëtare njoftojnë Komisionin me shkrim për të gjitha aeroportet për sa i përket mundësisë që ato kanë pranuar sipas pikës a ose pikës c të nenit 4 pika 3 të Rregullores (KE) nr. 2320/2002.

Neni 5 **Masat kompensuese**

Shtetet Anëtare njoftojnë Komisionin me shkrim për masat kompensuese që zbatohen në përputhje me pikën 4.2 të Shtojcës së Rregullores (KE) nr. 2320/2002.

Neni 6

Kjo rregullore hyn në fuqi më 19 prill 2003.

Kjo rregullore është detyruese në tërësinë e saj dhe drejtpërdrejt e zbatueshme në të gjitha Shtetet Anëtare.

Hartuar në Bruksel, më 4 prill 2003.

Për Komisionin

Loyola De Palacio

Zëvendës President

(1) GZ L 355, 30.12.2002, fq. 1.

SHTOJCË
Masa të detajuara mbi sigurinë e aviacionit

Në përputhje me nenin 3, shtojca është konfidenciale dhe nuk do të botohet në Gazetën Zyrtare të Bashkimit European.